



Buletini Alb-Shkenca

ORGAN I PERMUJSHEM I BOTUAR NGA FORUMI MBAREKOMBETAR I STUDIUESVE DHE SHKENCETAREVE SHQIPTARE ALB-SHKENCA ■ TETOR 2005

www.alb-shkenca.org ● <http://alb-net.com/pipermail/alb-shkenca> ● e-mail buletini@alb-shkenca.org

© Duke respektuar te drejtën e autorit asnjë material i botuar këtu nuk mund të riprodhohet pjesërisht ose plotësisht pa lejen e Alb-Shkencës

THIRRJA E ALB-SHKENCES PER PAVARESINE E KOSOVES

Duke përcjellë me vëmendje zhvillimet në Kosovë dhe përreth saj, duke e ndier situatën e ndërlikuar të proceseve nëpër të cilat po kalon çështja e Kosovës dhe duke e çmuar si shumë të rëndësishëm unifikimin e qendrimeve dhe fjalorit politik shqiptar rreth opsioneve në lidhje me statusin e ardhshëm të saj,

Ne, bashkëvendimtarët shqiptarë, të tubuar në një forum që bashkon njerëzit e shkencës dhe të mendjes, intelektualë dhe akademikë të ardhshëm, në trevat shqiptare dhe në diasporë, i bëjmë

THIRRJE

institucioneve shtetërore të Shqipërisë dhe të Kosovës dhe zërit të shpërndarë të shqiptarëve nëpër botë që të bashkohen në mbështetjen e pavarësisë së plotë të Kosovës, si e vetmja zgjidhje e drejtë për të ardhmen e saj.

Në këto momente historike në të cilat vendoset për fatet e Kosovës si dhe të kombit shqiptar në tërësi, mbetet imperativ zbatimi i platformës “një komb një qëndrim.”

Politikanët shqiptarë kanë dhënë prononcime të ndryshme në lidhje me të ardhmen e Kosovës, të cilat nuk dallojnë vetëm në nuanca, por edhe në përmbajtje. Ne shprehim indinjatën tonë të thellë ndaj deklaratës së ministrit të jashtëm shqiptar për një “pavarësi të kushtëzuar” për Kosovën dhe e konsiderojmë atë si një qëndrim që bie ndesh me të ardhmen e saj. Përkundër kësaj deklaratë, ne besojmë se vetëm pavarësia e plotë do ta nxirrte Kosovën nga status quoja dhe do të siguronte zhvillim paqësor dhe stabilitet për tërë rajonin. Prej Shqipërisë kërkohet të flasë me një gjuhë të përbashkët dhe pa ekuivoqe me faktorin shqiptar në Kosovë. Institucionet

shtetërore të Shqipërisë duhet të luajnë rol aktiv për një mobilizim të plotë kombëtar për ta ndihmuar procesin e shtetbërjes në Kosovë. Ndërsa, prej institucioneve të Kosovës kërkohet që të këmbëngulin në panegocueshmërinë e pavarësisë e cila më vete paraqet një kompromis që bëjnë shqiptarët në këtë fazë të proceseve politike në Ballkan.

Njëkohësisht, ne shprehim shqetësimin tonë për referencat e kohëve të fundit në shtypin e huaj për mospërputhje mendimesh dhe qëndrimesh në radhët e vet grupit negociues kosovar. Është koha që t’u jepet fund këtyre mosmarrëveshjeve dhe ndiejmë nevojën të theksojmë se procesi negociues dhe pavarësia e Kosovës nuk mund të fitohen kur interesat e grupimeve apo partive politike vihen mbi interesat kombëtare. E shohim si të domosdoshëm aktivizimin e menjëhershëm të grupeve të punës, të cilët do të mbështesin grupin negociator të Kosovës dhe njëherit shprehim gatishmërinë tonë që edhe ne të ndihmojmë në këtë drejtim.

Duke e përfunduar thirrjen tonë, ju përkujtojmë se shumë ngjarje që kanë ndodhur me shqiptarët në të kaluarën, kërkojnë prej institucioneve shtetërore të Shqipërisë dhe të Kosovës që të jenë shumë të vëmendshme për të ardhmen, nëse nuk duan që edhe vetë ato të jenë bashkëpërgjegjëse të ndrydhjeve të reja të qenies kombëtare shqiptare.

E kaluara e shqiptarëve është shumë e hidhur që të mos e kujtojmë.

Më 16.11.2005

Washington, Otavë, Berlin, Paris, Romë, Londër, Vjenë, Madrid, Sidney, Tiranë, Prishtinë

ALB-SHKENCA

Forum i mbarëkombëtar i studiuesve shqiptarë

ISH-DIPLOMATI AMERIKAN RICHARD HOLBROOKE FLET PËR KOSOVËN NË GAZETËN NZZ AM SONNTAG

“Nëse bashkësia ndërkombëtare i largohet përgjegjesisë,
atëherë nëpër rrugët e Prishtinës do të rrjedhë gjak”.

Ish-ndërmjetësi amerikan në konfliktet e Ballkanit Richard Holbrooke deklaroi në një intervistë me gazetën zviceriane *NZZ am Sonntag* se “gjatë katër viteve të fundit të presidencës së George W. Bush-it Amerika nuk ka lëvizur asnjë gisht për Bosnjën dhe Kosovën, përveçse ka tërhequr trupa ushtarake dhe ka humbur ndikimin. Por, administrata e dytë e Bush-it tani është zgjuar nga gjumi. Ministrja e jashtme Condoleezza Rice ka mbledhur rreth vetes një ekip të mirë, prej të cilëve disa, si nënsekretari Nick Burns, kanë punuar me mua dhe kanë marrë pjesë në arritjen e marrëveshjes së Daytonit”.

Lidhur me të ardhmen e Kosovës Holbrooke tha: “Kosova është shumë më e rrezikshme se Bosnja. Bosnja është një shtet i varfër, por banorët e saj me shikuj kanë jetuar paqësisht me njëri-tjetrin. Kosova është krejt ndryshe. Ajo i përngjan një fishekzjarri që mund të shpërthejë në çdo kohë”.

Holbrooke tha se patjetër duhet të hiqet dorë nga politika “standardet para statusit”. Kjo formulë, sipas tij, përherë ka qenë një floskul për një politikë qesharake. “Në fakt në çdo mbledhje, në të cilën bisedohet për të ashtuquajturat standarde – qoftë ndarja e ujit, rrymës apo të drejtat e refugjatëve dhe ish të burgosurve të luftës – fjala është vetëm për statusin, pra çështja a do të jetë Kosova krahinë serbe apo do të bëhet e pavarur. Kësaj çështjeje nuk mund t’i shmangeni. (...) Përherë kam tërhequr vërejtjen se “standardet para statusit” do të shtynin zgjidhjen dhe tensionet do të ngriheshin”.

Tito dhe Kosova

Në pyetjen e gazetës se formula e standardeve ka një logjikë, sepse nuk dëshirohet që të krijohen kufij të rinj ndërkombëtarë dhe pse të hiqet dorë nga ky parim, i cili kishte vlejtur për Daytonin, Holbrooke u përgjigj se problemi i Kosovës është më i komplikuar: “Shpesh merren parasysh vetëm republikat jugosllave, por duhet po ashtu të merret parasysh se Kosova nën Titon nuk u bë republikë vetëm për arsye se

në të serbët do të kishin mbetur pakicë. Nga ana tjetër Tito pranoi se Kosova është një rast i veçantë. Pra, të dy palët kanë argumenta. Kësaj i duhet shtuar se nuk mund të trajtohet si kushdo tjetër një territor, ku 90 për qind e popullsisë janë të pakënaqur me përkatësinë e tyre shtetërore”.

64 vjeçari Holbrooke tha se çështja e Kosovës mund të zgjidhet, por do të jetë shumë më vështirë se mes viteve 2000-2003. “Atëbotë Beogradi ka qenë i gatshëm për një marrëveshje, forcat e NATO-s kanë qenë më të fuqishme se sot. Tani tensionet mes serbëve dhe shqiptarëve janë shtuar, në fund të gushtit u vranë dy të rinj serbë. Dhe lajmi më i keq prej të gjithëve: kryetari kosovar Ibrahim Rugova lëngon nga kanceri në mushkri. Është humbur momenti (për zgjidhjen e çështjes së Kosovës). Kjo është keq, sepse të shfrytëzosh çastin është një ndër fshehtësitë më të rëndësishme të diplomacisë”.

I pyetur mbi propozimin e Zvicrës për një Kosovë me sovranitet të kufizuar, Holbrooke tha se nuk e njihete propozimin, por “një gjë është e qartë: Kosovës nuk mund t’i jepet pavarësia e plotë brenda një nate. Hapat në këtë drejtim duhet të kushtëzohen me garanci të udhëheqjes shqiptare për të drejtat dhe sigurinë e pakicës serbe. Serbët kanë qenë shtypës, por tani ata duhet të mbrohen nga aktet e dhunshme. Situata i përngjan asaj në Shlezi pas Luftës së Dytë Botërore, kur polakët vranë dhjetëra-mijëra gjermanë. Diçka e ngjashme do të përsëritej nëse urrejtja etnike në Kosovë do të rifillonte. Nuk duhen pasur iluzione: nëse bashkësia ndërkombëtare i largohet përgjegjesisë, atëherë nëpër rrugët e Prishtinës do të rrjedhë gjak”.

Enver Robelli
Gazetar/Korrespondent
Tages Anzeiger, Zvicër

SOLEMNITETI I PAARRIRË NË QYTETET E MUZETË TONA Portreti i vërtetë i Skënderbeut larg vendit që i takon

nga LEKË TASI

Çdo shtet ka kapitullin e vet ceremoni-
al, solemnitetet, përkujtimet, pritjet,
festat, monumentet, uniformat etj. Pava-
rësisht nga formalizmi dhe njëfarë ngur-
tësie që karakterizojnë këto manifestime,
është e nevojshme të mbahen, të përshko-
hen përherë e më shumë nga një estetikë e
thjeshtë dhe origjinale, si dhe të kenë një
seli sa më dinjitoze, në mënyrë që të përje-
tohen si një traditë e fiksuar dhe e ndjerë.
Ky është modeli që na vjen nga bota dhe ne
duhet të përfitojmë duke pohuar veçantinë
tonë. Momenti aktual nuk është ndofta nga
më të përshatshmit për tu kuptuar kjo
kërkesë, sepse sot në botë vihet re një prirje
çmitizuese për “lehtësim” nga formalizmat,
dhe kështu me klimën indiferente që për-
hapet në vendet e lodhura nga ideologjizmi
i tejmë i së kaluarës, ekziston mundësia që
qëndrat e fuqisë në botë tu induktojnë
atyre frymëzime antikonformiste e antiform-
aliste, gjithmonë duke mbajtur për vete
të paprekura ato forma e rituale që u kanë
bërë e vazhdojnë tu bëjnë punë. Kësisoj,
globalizmi merr edhe më vrull cen-
tralizues, jo vetëm në ekonomi,
por edhe në zakone duke reduk-
tuar vendet e referimit.

Për të reaguar, ne s’kemi mjet
tjetër veç tu dorëzohemi pikër-
isht atyre gjërave që rryma e
“emancipuar” i shpërfill si të ngar-
kuara me retorikë. Përderisa të kënd-
uarit e hymnit, valëvitja e flamurit, vazhdon
të ngjallë emocion tek njerëzit, kjo do të
thotë se ekziston ende një ndjenjë kohezive,
të cilën duhet ta ruajmë e ta shtojmë si një
gjë të çmuar. Pa këto rituale e “formalizma”,
qyteti, bile edhe shteti, eventualisht dhe i
mirëqenur, bëhet si një nga ato “portet e
lira”, ku tregtia lejohet për këdo dhe ku jeto-
het mirë, por që s’ka asgjë ideale që ta



mbledhë. Në skajin e përkundërt, të banali-
zimit, qëndron shija e dobët, moskujdesi,
pandjeshmëria që investohet në koncepti-
min dhe performimin e solemniteteve, me
rezultate të vajtueshme siç i kemi pasur ne
(p.sh. me shumëzimin e djeshëm pa nivel të
muzeve, i fundit i të cilëve aktualisht në
Korçë, megjithëse i destinuar për art, ngjet si
kioskë për shitjen e arançatave). Për t’iu
shmangur kësaj katandije, lypet shfrytëzimi
në maksimum i kulturës dhe i aftësisë artis-
tike të disponueshme dhe dorë e lirë për sa i
përket shpënzimeve. Pikërisht këto kanë
çuar në Evropë në daljen gjatë kohërave,
krahas një Versaje e një Potsdami, edhe të
qyteteve e kryeqyteteve të shkëlqyera
vendesh të vogla, që mund të krahasohen
me koka të mëdha e të përkryera mbi trupa
të vegjël. Egocentrizmi dhe ndjenja e mad-
hësisë e monarkëve, por edhe e popujve,
ka lënë kështu trashëgim diadema të atilla,
që jo vetëm ua bëjnë jetën të gëzueshme
edhe sot banorëve dhe vizitorëve, por janë të
afta t’i dalin mbanë edhe asaj fazës që për-
mendëm më lart, të mehjes së for-
malizmit pa ulur shkallën e
solemnitetit, sepse mbeten ata
vetë dëshmitare të madhër-
ishëm të së kaluarës, që i japin
vlerë ritualitetit më të thjeshtë
edhe sot e mbrapa. Në këtë
mënyrë mbijeton në kohë e ve-
çanta e ofruar nga secili popull, pra
ajo larmi kulturore që e shpëton botën
nga përthithja globale. Turizmi pra – bas-
tion i fundit i nacionalizmit.

Shqipëria erdhi në pavarësi me fare pak
ndërtesa të vlefshme për këtë funksion,
kurse shekulli XX shtoi pak të tilla dhe
mjaft të tjera të “gabuar”, që për dobësi
gjithëfarësh i largohen këtij destinacioni.

Shkodra dhe Vlora, me ndërtesat e pre-

fakturave respektive dëshmojnë për të mirën e pakët por të saktë që na kanë lënë të huajt, dhe ajo që i përmbledh është fjala “barok”, sado pa pretendime. E habitshme sa të rralla përsëritjet e mëvonshme: ndërto, shtëpia e oficerëve. Na mungon me të vërtetë ajo çitadelë e veçantë, që me një farë shkëlqimi, bashkon vlera historike dhe artistike me një densitet të tillë sa të përbëjë sinekdokën e krejt vendit. Ministrinë sidoqoftë realizojnë në një farë mase kriterin që vë ambicien për prestigj përmbi varfërinë e mjeteve; qëndrojnë mirë edhe sot. Më dobët paraqitet ndërtesa e Presidencës (vitet '60), kurse Muzeu Historik Kombëtar (vitet '80) të lë të pakënaqur dhe me siguri shumica e të pyeturve, do të deklaroheshin për një zgjidhje ndryshe, më pak kabà dhe me eksponate më të sakta. Muzeu i Krujës, edhe ky i viteve '80, që një “bravatë”, me ato eksponate jo të vërteta por të sajuara (!) gjë që ngjall njëherazi skuqje ngaqë aty ekspozohet varfëria jonë, por dhe njëfarë simpatie që u gjet guximi të tentohet njësoj; është punuar me zell dhe dashuri nga artistët, veçse me ekonomi dhe ngushtë, si dhe pa gjetje gjeniale në konceptim siç do të duhej në këto raste – koha e ndryrë komuniste s'lejonte konkurs ndër-kombëtar.

Stisja në përgjithësi me të cilën është bazuar muzeologjia jonë, e ka shkaku në partjetër tek ai “plugim i thellë” që i bëri pushtuesi shekullor tokës sonë; shumë pak objekte autentike kanë mbetur në këmbë, asnjë sallë e mbuluar dhe e pajisur s'na vjen direkt nga e kaluara në kështjellat tona, të gjitha pa çati, të rrënuara! Stërnipat e familjeve të mëdha që emigruan përtej Adriatikut, i kanë të mbushura kështjellat me dokumenta e eksponate, por ato i përkasin tashmë historisë së tjetërkujt. Degët e këtushme të atyre familjeve s'kanë patur ç'të na ofrojnë, sepse në vend të ruajtjes dhe dokumentimit të së kaluarës, kanë parapëlqyer grabitjen dhe shterrimin e së tashmes, me rezultat që një mendësi prej këpushe të përhapet në çdo nivel, mendësi që jo perëndimore e evropiane, por as lin-

dore s'mund ta quajmë. Megjithatë që një pinjoll i atyre familjeve, që i shartuar me kulturë evropiane dhe gjenial vetë, bëri hapin e parë duke orientuar opinionin tonë të porsaformuar rilindas drejt kërkimit të relikes, dokumentit dhe simbolit: Faik Konica. Qe një fillim i mbarë. Megjithatë s'ishte e thënë që pastaj fuqinë ta trashëgonte një aristokrat i kultivuar si ai, për të ngritur qoftë me mjete të fantaksura si të mbretërve të moçëm, ekuivalentin shqiptar të qendrave – stoli, siç kanë bërë për kënaqësinë e tyre të fortët e vendeve të tjera. Ndodhi e kundërta: krahas lumit të harxheve për bunkerë, u banalizua muzeologjia në maksimum, dhe – çka do ta ndjejmë ende gjatë derisa të arrijë ekonomia të përballojë prishjet masive – u zhduk çdo hapësirë qëndrore e përshtatshme për të vendosur madhështinë e shumëvonusuar, atë çitadelë që u përmend më lart.

Me këto mungesa në aktiv, nuk mbetet veçse të drejtojmë vëmendjen tek sallat e muzeve, qoftë tek një e vetme, ku të përmbliidhen objektet kapitale të historisë sonë. Aktualisht vizitori në Muzeun Historik Kombëtar ndeshet me boll shkrime të mëdha në mure, harta, foto të zmadhuara, armë anonime, portrete e statuja të shpikura, por me kaq shumë të tilla sa ia shkatërrojnë paraprakisht veneratën për eksponatet kryesore, të cilat edhe pse në kopje, duheshin veçuar dhe privilegjuar në vendosje. Me një fjalë është vënë shenja e barazimit mes momentit emocional dhe atij indoktrinues, e ca më keq, mbushës, çka vë në dukje nietin e ideologjive marksiste që t'i jepet vendi parësor masës e propagandës dhe jo heroit. Prandaj dhe linja është e pashkëputur, pa një kulm të kushtuar kryeheroit.

Tre janë objektet që çdo shqiptar pret t'i shohë të ekspozuara në një vendosje sa më solemne: përkrenarja, shpata dhe portreti i vërtetë i Skënderbeut. Ato do të meritonin të qëndronin të vetmuara në një sallë hijerëndë. Në fakt sot janë shpërndarë nëpër cepa e hatulla të një linje të pashkëputur, pranë statujash prej allçie të bëra me porosi dje ose fotosh të ilustrimeve nga gazeta të

vana evropiane, që kanë zënë kryet e vendit. Është rrafshuar pra autentikja me të sajuarën, duke ia lënë vendin e nderit të dytës, shenjë kjo e një shije të ulët. Mund të thuhet se shija e keqe ka shoqëruar historinë tonë të re, pahiri e rrëmbimi, nuk mund të mos kenë bashkudhëtarë varfërinë, inkompetencën, uzurpimin nga të paaftët, dhe kështu objektivisht dhe subjektivisht, eleganca, arti, sensi i madhështisë janë të dënuara të rrijnë larg.

Aspirata që përkrenarja dhe shpata (të vërtetat) të transferohen një ditë në Shqipëri, falë një gjesti bujar të Austrisë, sigurisht pas kërkesash e lutjesh këmbëngulëse e sidomos pas rehabilitimit tonë si shtet, qëndron thellë tek çdo shqiptar që emocionohet veç me mendimin që ato i ka prekur e përdorur heroi ynë. Objekti i tretë, portreti, i bërë sipas natyrës nga piktori i madh venecian Gentile Bellini, ose më saktë, nga Cristofano dell'Altissimo sipas Bellinit, ka pasur qoftë si kopje një fat të habitshëm ndër ne, artistë e popull. Duke u përqëndruar kërkesat e publikut tek monumentet, u gjend me vend tërë shekullin e XX-të që heroi të rinohet në raport me portretin mesjetar, për tu bërë më luftarak. Kështu, tiparet pleqërishte por të vërteta të portretit origjinal u lanë mënjanë, dhe në vend të tyre u parapëlqye mjekra e shkurtër, qafa e gjatë e muskuloze dhe vetullat e kërlëshura me hundën shkabë në mes. Këto tipare të reja që u shpikën dhe u ligjëruan edhe me anën e kokës së dhisë, stisën një Skënderbe tjetër, që s'ka të bëjë me të vërtetin, por që ka uzurpuar vendin e të vërtetit tashmë në imagjinatën popullore. Është nënvlerësuar dhe gati harruar kësisoj, një shekull të tërë, plaku i tmerrshëm, syri i madh i të cilit të shtie drithmën, Skënderbeu i vërtetë, i moshës së thyer vërtet, por edhe luftëtar siç e thotë historia, ai profil me shenjën e plagës pranë syrit dhe me tërë fragrancën e veshjes së tij mesjetare; pra të vetmin imazh që do të na homologonte në muzeologjinë evropiane, e kemi lënë menjëherë (mos të çuditemi nga devijimet e turmës: ajo mund ta mbajë në kujtesë figurën e

heroit edhe ashtu si ia dha Akaki Horava).

Tani, nëse skulpturën monumentale edhe mund ta kuptojmë deri diku, ngaqë masa popullore së cilës i drejtohet, sheh kryesisht siluetën, kalin, mamuzet, topuzin, dhe e do heroin djaloshtar, braktisja që i ka bërë portretit të vërtetë piktura profesioniste dhe portretistët në shërbim të muzeologjisë, është fare e papërligjur. Ka ndodhur sigurisht nga shkalla e ultë e kulturës dhe siç thamë nga mbizotërimi i një shije vulgare. Shteti i kulturuar do t'i kishte dhënë vendin parësor atij portreti, dhe do të shpërfillte ilustrimet e fryra e me shije të dobët. Njohësi, specialisti, bën dallimin, vë re tiparet, sytë, se aty qëndron personaliteti, dhe ai piktor i Rilindjes italiane ia ka dhënë më së miri. Pastaj mos të harrojmë se Skënderbeu ishte një fenomen nga pikëpamja fizike, nga shpjegohet edhe karriera e tij e gjatë luftarake, ai praktikisht ka kaluar nga fusha e luftës në shtratin e vdekjes dhe pasqyrimi i këtij fakti do ta bënte më të plotë figurën artistike. Kështu nëse ai u pikturua më 1461 gjatë udhëtimit të parë në Itali, ai vjen direkt nga beteja e Ursarës, por edhe nëse më 1465, udhëtimi i dytë, ai posa ka mundur Ballaban Pashën dhe përgatitet ta dërrmojë mbas pak. Sa madhështor do të ishte ai portret po të kthehej në ekuestër!

Një skulptor i Rilindjes do ta bënte, sepse arti i madh i asaj kohe rrokte idenë tek personazhi, dhe tek Skënderbeu ideja qëndrore është të luftuarit deri në fund, duke sfiduar kufijtë e moshës, çdo ide tjetër e ngushton, është kufizuese për të, aq më shumë kur është jo e marrë nga realiteti; të gjithë e dimë se me sa gjenialitet asokohe përfshihej dhe jepej në art e veçanta (deri edhe e shëmtuara. Disa portrete të Ghirlandaios, Dürerit, Velasquezit janë veç pak shembuj) për të dhënë larminë, pasurinë e paanë të jetës reale. Por le ta lëmë skulpturën monumentale me krijimet e saj arbitrare. Por muzeologjia duhej të vazhdonte fillin tjetër atë të dokumentit, për ta vënë përballë liçensës (pak a shumë të suksesshme) dhe folklorizmit të shpallur.

Si përfundim pra, Skënderbeu i vërtetë tabloja e Bellini-Cristofano dell'Altissimi, i vetmuar, me dimensione të mëdha, pa diçiturën në sfond, pa asgjë tjetër afër dhe me një ambientim solemn, duhet vendosur atje, në Muzeun Kombëtar si stacion qëndror e kulmor të itinerarit, si dhe kudo

gjetkë në institucionet qëndrore ku duam të mbajmë, të simbolizuar së paku, edhe pse shumë pak të realizuar, dinjitetin, sovranitetin e shtetit tonë. Ai të jetë objekti numri një i çdo solemniteti në salla të mbyllura dhe në materiale të botuara normative.

Në Parlamentin Britanik prezantohet *Lahuta e Malcisë*

Daut Dauti, Londër

Në vitin 1980, në Cambridge, Noel Malcolm kishte hyrë në një librari të këtij qyteti universitar dhe kishte kaluar disa minuta duke shikuar titujt që i interesonin. Kur Noel Malcolmi i ishte afruar shitësit për ta pyetur nëse kishte ndonjë libër për shqiptarët, shitësi ishte stepur nga habia. Kishte qëndruar ashtu në heshtje një kohë të gjatë dhe pastaj ia kishte shkrepur gazit. Pa emocion shitësi kishte arritur të shtonte: E kush i shkruan dhe kush do t'i lexonte ato libra?

Po atë kohë, diplomati i njohur britanik dhe miku i shqiptarëve, i ndjeri Sir Reginald Hibbert, kishte shkuar në Foreign Office dhe në raftet e Departamentit për Adriatikun Lindor kishte kërkuar shënime për Shqipërinë. Nga tërë volumet që kishte shfletuar në rafte ai gjeti vetëm një hartë të Shqipërisë. Kaq ishte interesimi për shqiptarët dhe vendin e tyre.

Sot, pas një çerek shekulli, situata ka ndryshuar aq shumë saqë gati çdo ditë shkruhet diçka për shqiptarët. Shtëpi botuese, të rëndësishme e të pa rëndësishme, tash angazhohen me botime për Shqipërinë e sidomos për Kosovën. Vetëm "Centre for Albanian Studies", nën udhëheqjen e Bejtullah Destanit ka botuar mbi 10 botime të rëndësishme për historinë, politikën dhe kulturën e shqiptarëve.

Në mbrëmjen e 26 tetorit 2005, në Parlamentin Britanik u bë prezantimi i dy librave të rëndësishëm që "Centre for Albanian Studies" ka ndihmuar për ti botuar. Në këtë institucion me rëndësi të veçantë për jetën politike u mbledhën personalitete të rëndësishme britanike, shqiptare dhe të tjerë. Në mesin e politikanëve dhe akademikëve vendas nuk munguan as diplomatët e huaj të akredituar në Londër. Promovimin e librave *Highland Lute* (Lahuta e Malcisë) dhe *Ali Këlcyra – aristokrati kuq e zi* e organizoi John Austin, anëtar i parlamentit dhe kryesues i grupit gjithëparlamentar për Kosovën. Fjalime të rastit mbajtën edhe John Hodgson (albanolog), Kastriot Robo (ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Londër) dhe Tanush Frashëri (autori i librit *Ali Këlcyra – aristokrati kuq e zi*).

Nga fjalimet e tyre dhe nga biseda me personalitetet e pranishëm në këtë prezantim kup-tohet qartë se çështja e Kosovës edhe një herë po kthehet në qendër të vëmendjes në politikën britanike dhe në diplomacinë botërore. Kanë filluar angazhimet politike dhe diplomatike të britanikëve të nxehen sërish. Intelektualët poashtu kanë filluar të lëvizin. Kësaj here shumë më fuqishëm dhe shumë në përkrahje të shqiptarëve, gjegjësisht Kosovës. Me fjalë tjera, shumë më ndryshe së para 25 viteve.

PER SKENDERBEUN: ME DISA TE DHENA MBI ORTODOKSINE DHE BOSTONIN

(Mbrëmje kushtuar 600 vjetorit të lindjes së Skënderbeut, Boston, 29 tetor 2005)

AT ARTHUR LIOLIN

Librin e tij autoritativ botuar në anglisht për heroin tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeun, Fan S. Noli e fillon me këto fjalë: “Çdo hero në histori kalon tre etapa, atë të lavdisë, të rrënimit dhe të rivlerësimit. Kjo do të thotë që në fillim ai ngrihet në qiell nga admiruesit e tij, pastaj rrënohet nga kritikët dhe më së fundi... me durim, me mundim dhe me kujdes vështirësie rivlerësohet përsëri nga historianë që janë esëll dhe jo të verbuar nga fanatizmi i admiruesve të heroit dhe as nga tërbimi i kritikëve të tij”.

Kështu, Noli vazhdon të thotë se hero i madh Gjergj Kastrioti do të ketë kaluar gjithashtu nëpër këto tri etapa shqyrtimi. Ka shkencëtarë të aftë dhe kompetentë për të vlerësuar dhe hulumtuar rëndësinë e figurës së Skënderbeut në histori, kurse për ne të gjithë ai mbetet gjithmonë ylli më i ndriçuar i kombit me të cilin identifikohen të gjithë ata dhe ato që e quajnë veten shqiptarë.

Megjithatë, për të pasuruar dijet tona për të dua të parashtoj disa të dhëna që mund të na interesojnë sot për jetën e tij në lidhje me aspektet fetare, ose më mirë qendrimin e tij ndaj konfesioneve në fe.

E para: rreth debatit për besimin e Skënderbeut. Në një mënyrë, Noli e kapsulizonte këtë aspekt me thenien se: “Skënderbeu u lind si ortodoks, jetoi si mysliman dhe vdiq si katolik.” Duke evituar një analizë të thellë të ndërgjegjes së tij fetare, me pak fjalë mund të themi se Skënderbeu ishte një nga të parët e diplomacisë së “realpolitikës.” Domethënë herë pas here ai bëri aleanca diplomatike të disaanëshme me ata që mund të ndihmonin pavarësinë e shqiptarëve dhe mbretërinë e tij, që ishte qëllimi kryesor i veprimeve të tij. Kështu, nganjë-

herë u lidh me principatat perendimore si me Shtetin Papal ashtu edhe me Venedikun, tjetër herë me Hungarinë dhe Ferdinandin e Italisë jugore.

Gjithashtu, ca spekullojnë se nuk duhet harruar periudha kur Gjergji në moshë të re jetoi në Stambollin e Sulltanit, ku i dhanë emrin Iskander për aftësitë e tij ushtarake të jashtëzakonshme. Në këtë kohë trashëgimi i Perandorisë së lindjes bizantine nuk ishte krejt i larguar nga ambienti i kryeqytetit dhe mbase më vonë mbeti i ngulur në mendjen e tij si një lloj prototip qeverisjeje. Ka dhe spekulime që thonë se një nga qëllimet e tij mund të ishte restaurimi i periudhës së mëparshme të ashtuquajtur të “Romës së Re” në bregdetin e Bosforit.

Kemi edhe një rast tepër interesant, atëherë kur hyri të fejojë kunatën e tij, Angelina Arianiti (motra e vogël e bashkëshortes së tij Donikë) me princin serb. Më vonë Angelina, e cila ishte një fetare e thellë, u shpall shenjto e Kishës ortodokse dhe emri i saj qendron edhe sot në kalendarin kishtar të kristianizmit lindor. Në kryekishën tonë të Shën Gjergjit kemi një ikonë muri me imazhin e saj: “Shën Angelina e Shqipërisë.”

Një shembull tjetër i realpolitikës së tij janë rastet, sado të përkohëshme, kur hë për hë ai i qendroi luftës me sulltanin dhe Portën e Lartë për të mos patur luftra në dy fronte në të njëjtën kohë, në veçanti në ato momente kur kishte probleme me Doxhën e Venedikut, ose kur erdhën lëvdata të shumta dhe ndihma morale por jo mjaft materiale nga Roma dhe Perëndimi për të përballuar luftën.

Por, nuk ishte vetëm realpolitika ose përshtatshmëria në thelb të veprimtarisë së tij; baza kryesore sipas mendimit tim ishte “idealizmi” i tij për të mbrojtur popullin

dhe vendin e tij gjer në fund, me një vendosmëri dhe aftësi strategjike të mrekullueshme. Për këtë qëndrim, emri i Skënderbeut do mbetet përgjithmonë për ne, pa dallim feje, si imazhi dhe frymëzimi themelor i ndërgjegjes kombëtare.

Aspekti mbi ortodoksinë e tij është dokumentuar edhe në historinë e të atit: Gjon Kastrioti. Në Manastirin e Kilandarit në Malin e Shenjtë (Aghion Oros) gjendet një dokument tepër interesant që ilustron më shumë lidhjet e hershme të fesë me fisin Kastrioti. Në arkivin e manastirit mund të gjejmë një dorëshkrim ku është nënshkruar një marrëveshje ndërmjet Gjonit me abatin e manastirit në fjalë. Si këmbim, të disa fshatra në rrethin e Krujës do të dorëzonin fitimet e tyre për manastirin. Aty thuhet se nëqoftëse otomanët do ta kapnin Krujën, familja e tij do të gjente strehim në manastir. Të gjithë e dimë që historia më vonë mori një rrugë tjetër me lidhjet e Skënderbeut me principatat e gadishullit Italik. Veç kësaj, e dimë se vellai i Gjergjit, i quajtur Riposhi ishte murg ortodoks po në manastirin e Kilandarit.

Përfundoj komentet e mia të shkurtëra me një episod historik që nuk njihet prej shumë të tjerëve. Flasim për ngjarjen kur u themelua kisha jonë këtu në Boston në vitin 1908, pas meshës së parë në gjuhën shqipe që kryesoi at Fan Noli.

Besimtarët patriotë ishin në mbledhje dhe debat se cilin emër shenjtori do të zgjidhnin që të emëronin kishën e re. Një pjesë e madhe e pjesëmarrësve, me origjinë nga fshtati Katund kërkonin patronazhin e Shën Mitrit, se ishin mallëngjyer nga kisha adashe e atjeshme. Noli propozoi të emërohet kisha pas Shenjtit Gjergj, rekomandim që i kish bërë Faik Konica privatisht. Katundlinjtë u ngazmuan duke pyetur: “Pse Shën Gjergj? Kishat më të njojtura në Korçë dhe në Dardhë i janë kushtuar Shën Gjergjit?” Noli u përgjigj: “Jo, nuk e sugjeroj për tju bërë qejfin as korçarëve e as dardharëve. Mirë është ta vendosim kishën tonë pas emrit të Shën Gjergjit se ai ishte patroni i heroit tonë më të madh Gjergj Kastrioti Skenderbeu.”

Me vota unanime, brohoritje dhe duartrokitje, kështu u bë, dhe katedralja e kryekishës sonë gëzon sot e kësaj dite emrin e tij.

SKENDERBEU PENG I SULLTANIT

Në referencën e at Arthur Liolinit për vitet e rinisë së Skënderbeut si peng në oborin e sulltanit ka një pasaktësi të vogël. Në tekstin e dhërguar në Alb-Shkenca thuhet:

“... Gjithashtu, ca spekullojnë se nuk duhet harruar periudha kur Gjergji në moshë të re jetoi në Stambollin e Sulltanit, ku i dhanë emrin Iskander për aftësitë e tij ushtarake të jashtëzakonshme. Në këtë kohë trashëgimi i Perandorisë së lindjes bizantine nuk ishte krejt i larguar nga ambienti i kryeqytetit dhe mbase më vonë mbeti i ngulur në mendjen e tij si një lloj prototip qeverisjeje.”...

Skënderbeu jetoi pranë oborrit të sulltanit nga viti 1412 deri më 1443. Në atë kohë kryeqyteti i Perandorisë Osmane ishte Edreneja (Adrianopolis). Perandoria Bizantine jo vetëm që nuk ishte e larguar në kohë por, ndonëse në ditët e saj të fundit, ajo ishte një fakt i gjallë dhe Konstandinopoja ishte kryeqyteti i saj. Ky qytet i famshëm që osmanët e pagëzuan Stamboll u pushtua nga Sulltan Mehmeti II në vitin 1453, kur Skënderbeu ishte në kulmin e angazhimeve të tij ushtarake antiturke në vendin e tij. Pra ai nuk ka pasur madje as mundësinë më të vogël që të shkelë, qoftë edhe një herë të vetme, gjatë jetës së tij, në Stamboll.

Skender Shkupi

VAZHDIMI I NJE DISKUTIMI MBI AKADEMINE E SHKENCAVE

nga TANUSH SHASKA
Oakland University, Michigan (ShBA)

Ditët e fundit ka nisur një diskutim i hapur në disa organe të shtypit mbi rolin e akademisë së shkencave dhe nevojën e reformimit të saj. Artikuj mbi akademinë e shkencave ka pasur edhe më parë në shtyp. E reja e këtyre ditëve të fundit është pjesëmarrja në këtë diskutim e disa anëtarëve të akademisë së shkencave si Prof. Golemi dhe Prof. Beqja. Për herë të parë duket se akademikët tanë ndejnë njëfarë përgjegjësie për të justifikuar veprimtarinë e institucionit ku paguhen. Për këtë merita i takon këshilltarit të kryeministrit i cili me një intervistë bëri më shumë punë se qeveritë e 15 viteve të shkuara.

Intervista e dates 28 tetor 2005 nga *Tirana Observer* me Prof. Golemin titullohej "Ndryshimet në Akademi rrezikojnë shkencën". Prof. Golemi për cilën shkencë e keni fjalën? Shqipëria meriton më shumë se kaq! Prof. Beqja sugjeron se kritikën drejtuar akademisë së shkencave shpesh kanë qenë inatçore ose pa detaje. Duke shprehur respektin më të thellë për profesorët e lartpërmendur, unë dua të jap disa detaje të cilat shpresoj se do të ndihmojnë publikun dhe profesorët për të kuptuar disa nga kritikën drejtuar Akademisë.

Roli i akademisë së shkencave në shumicën e vendeve të botës është honorifik (me fjalët e thëna nga Prof. Beqja), ose udhëheqës në kërkimin shkencor të një vendi. Shumica e vendeve kanë kombinuar të dy rolet e mësipërme dhe akademitë e tyre kryejnë të dy funksionet. Në qoftë se roli i Akademisë do të jetë honorifik atëherë anëtarët e Akademisë nuk duhet të jenë punonjës me pagesë, në të kundërt atyre duhet t'u kërkohet llogari si gjithë punonjësve të tjerë të shtetit. Megjithatë, pak rëndësi ka se cili duhet të jetë roli i Akademisë, pyetja kryesore është sa efikase ka qenë ajo dhe a duhet reformuar?

Ashtu si Prof. Beqja e shmangte veten nga vlerësimi i programeve të Akademisë për shkencat natyrore dhe teknike edhe unë do të shmang veten për arsye paaftësie mbi dhënien e vlerësimit për shkencat shoqërore dhe do të përqëndrohem tek shkencat ekzakte. Aktiviteti shkencor i Akademisë në këto shkencë është pothuajse jo ekzistues. Përderisa profesorët kërkuan detaje, unë po jap disa detaje.

Unë dua të pyes profesorët e mësipërm dhe kolegët e tyre të Akademisë se cilat janë meritat apo kërkimi shkencor i zotit Skënder Gjinushi i cili është anëtar i Akademisë prej viteve '80? A

mund të sqaroni publikun a keni votuar ju personalisht për pranimin e zotit Gjinushi apo ai thjesht është emëruar nga qeveria?

Unë nuk jam i aftë të gjykoj mbi meritat shkencore të shumë prej anëtarëve të Akademisë, por jam në gjendje të gjykoj me kompetenca mbi meritat shkencore të zotit Gjinushi. Ai gjatë gjithë karrierës së tij shkencore ka dy artikujt e mëposhtëm:

• S. Gjinushi, *Espaces de Fréchet fortement différentiables ou Gâteaux différentiables*. (French) C. R. Acad. Sci. Paris Sér. A-B 286 (1978), no. 1, A41-A44.

• S. Gjinushi, *Espaces localement convexes séparés différentiables*. (French) Séminaire Choquet, 16e année (1976/77), Initiation et l'analyse, Exp. No. 11, 14 pp. Secrétariat Math., Paris, 1978.

Një rekord i tillë është i pamjaftueshëm në çdo vend përëndimor për të siguruar një punë të përhershme në universitet. Vetëm në Shqipëri individë të tillë mund të bëhen anëtarë të Akademisë. Është turp për vendin tonë që standartet të ulen deri këtu.

Ju lutem më sqaroni publikisht, ju ose ndonjë anëtar tjetër i Akademisë, përse është S. Gjinushi anëtar i Akademisë? Ai nuk ka ndonjë meritë shkencore për të justifikuar anëtarësinë në Akademi dhe me sa di unë këto 15 vitet e fundit energjitë e tij ia ka kushtuar PSD-së dhe jo shkencës. E kjo na sjell një pikë tjetër. Proçesi i zgjedhjes apo emërimit të anëtarëve të Akademisë gjatë gjithë kohërave ka qenë i politizuar dhe si rrjedhojë i paligjshëm.

Është e vërtetë se disa nga anëtarët e meritojnë anëtarësinë, por kjo asnjëherë nuk mund ta bëjë proçesin legjitim. Padrejtësia më e madhe në këtë sistem të politizuar ju bëhet atyre akademikëve të cilët vërtet e meritojnë këtë emër.

Unë uroj që kryeministri vërtet t'a shpërndajë Akademinë e Shkencave dhe t'a krijojë atë nga e para. Në proçesin e riorganizimit të saj shpresoj të përfshihen të gjithë ata që për arsye politike nuk u përfshinë kurrë nga qeveritë komuniste e socialiste. Shpresoj që kandidatët e ardhshëm për akademikë të vlerësohen nga puna e tyre shkencore në botë. Uroj që për çdo vend të Akademisë të propozohet më shumë se një kandidat. Shpresoj që opinioni i shkencëtarëve të huaj të kërkohet mbi çdo kandidat. Dhe më e rëndësishmja, uroj që politikanët e çdo partie të qëndrojnë sa më larg këtij proçesi.

AIEA (AGJENCIA NDËRKOMBËTARE E ENERGJISË ATOMIKE DHE DREJTORI I SAJ, EGJIPTIANI ELBARADEI

Aiea është një agjenci e Organizatës së Kombeve të Bashkuara e krijuar më 1957 me seli në Vjenë.

Motivimi – Komiteti që përgatit dhënien e çmimit nënvizon «përpjekjet e agjencisë Aiea dhe drejtorit të saj që energjia bërthamore të mos përdoret për qëllime ushtarake e për të siguruar që kjo energji të përdoret për qëllime paqësore në mënyrën më të sigurtë që të jetë e mundur. Në një epokë kur kërcënimi i armëve atomike është kthyer përsëri në plan të parë, ky rrezik duhet përballuar me anë të një bashkëpunimi më të gjerë ndërkombëtar. Ky është një parim që sot gjen shprehjen e tij më të qartë në punën e Aiea-s dhe drejtorit ElBaradei.

ElBaradei – 63 vjeçar, ai drejton Aiea-n qysh nga viti 1997. “Çmimi Nobel do të shtojë më tej këmbënguljen time e të kolegëve për të vazhduar luftën kundër përhapjes së armëve nukleare në botë”.

Kundër luftës në Irak, akuza Koresë së Veriut dhe Iranit – “Kjo është dita më prestigjioze për Aiea-n” tha zëdhënësja e agjencisë Melissa Flemming. Aiea dhe ElBaradei iu kundërvunë qysh në fillim luftës në Irak duke theksuar se nuk ekzistonin provat e një programi atomik ushtarak të regjimit të Sadam Huseinit. Për këtë patën debate të ashpra me administratën amerikane Bush e cila bëri të pamundurën për të mos e zgjatur mandatin e drejtorit egjiptian. Në të kundërt, ElBaradei u rizgjodh në krye të Agjencisë edhe për katër vjet të tjerë. Së fundi Aiea ka denoncuar Korenë e Veriut dhe Iranin në përpjekjet e tyre për të përdorur centralet bërthamore edhe për qëllime ushtarake.

★ FIZIKE

Çmimi Nobel për fizikën iu dha amerikanëve Roy Glauber e John Hall dhe gjermanit Theodor W. Hänsch për studimet e tyre në fushën e optikës, të tre shkencëtarët u vlerësuan për kontributin e tyre në kuptimin e fenomeneve optike dhe zhvillimit të spektroskopisë së bazuar mbi rrezet lazer me precizion të lartë. Falë studimeve të tyre u arrit të dallohen konstantet e natyrës, të prodhohen orë me precizion tepër të lartë dhe ti jepet një shtytje e mëtejshme teknologjisë GPS (Global positioning system).

Çmimi pjesërisht i jepet Roy Glauber (80 vjeç) nga universiteti i Harvardit për kërkimet e tij mbi sjelljen e grimcave të dritës që kanë kontribuar ndjeshëm në teorinë kuantike të koherencës optike. Pjesa tjetër e çmimit ndahet midis Hall (71 vjeç), universiteti i Kolorados dhe Hänsch (64 vjeç) nga Instituti Max Plank i optikës kuantike në universitetin e Mynihut, për kontributin e tyre në spektroskopinë e precizionit të bazuar në rrezet lazer.

“Qysh nga koha kur njeriu populloi tokën, ai u mahnit nga fenomenet optike e dalëngadalë ka zbuluar natyrën e dritës. Çmimi Nobel për fizikën këtë vit iu jepet tre shkencëtarëve që kanë dhënë një kontribut tepër të rëndësishëm në këtë fushë” lexohet në faqen elektronike të Akademisë suedeze.

Maxwell në gjysmën e dytë të Tetëqindës zbuloi se ashtu si valët e radios, edhe drita është një formë rrezatimi elektromanjetik. Mbi këtë bazë teknologjia moderne e komunikacionit, e mbështetur tek transmetitorët dhe receptorët, ka mundur të përpunojë radion, televizionin dhe telefonët celularë. Drita ka një natyrë të dyfishtë e mund të konsiderohet me valë apo si një rrymë grimcash.

Roy Glauber hodhi bazat e optikës kuantike, në të cilën teoria e kuantëve ka përfshirë edhe fushën e optikës. Shkencëtari i Harvardit shpjegoi kështu ndryshimet bazë midis burimeve të ngrohta të dritës (p.sh. llambat) dhe kombinimet e fazave dhe frekuencave duke kaluar më tej tek rrezet lazer që japin një fazë dhe frekuencë specifike.

Falë kontributit të dhënë nga John Hall e Theodor Hänsch u arrit të mateshin me një saktësi të lartë frekuencat. Kështu, sot mund të ndërtohen aparatura lazer me një precizion tepër të lartë dhe u përpunua një teknikë leximi për të gjithë ngjyrat që përbëjnë dritën. Midis aplikimeve praktike të këtyre zbulimeve është i mundur studimi i qendrueshmërisë së konstanteve të natyrës në kohë.

* KIMI

Çmimi Nobel për kiminë u dha shkencëtarit francez Yves Chauvin dhe dy shkencëtarëve amerikanë Robert Grubbs e Richard Schrock. Të tre kimistët u nderuan për zbulimet e tyre të arritura në studime të pavarura lidhur me një nga reaksionet më të rëndësishme të kimisë organike, metatezën, falë së cilës u bë i mundur prodhimi në laborator i molekulave të reja si ato me interes farmaceutik ashtu edhe ato të lëndëve plastike e kimike të padëmshme për mjedisin.

Termi metatezë do të thotë “ndërrim vendi” dhe është një reaksion i kimisë organike ku prishen lidhjet midis atomeve të karbonit në lëndët organike dhe elementëve të tjerë si hidrogjeni dhe oksigjeni tamam si në një ballo ku çiftet ndërrojnë partnerët me njeri-tjetrin. Bëhet fjalë për një reaksion bazë në kiminë organike sepse e gjithë jeta mbi tokë mbështetet tek përbërjet me bazë karboni. Kuptimi i të gjithë mekanizmave të reaksionit të metatezës i hap rrugën mundësisë për prodhimin artificial në laborator të përbërjeve të karbonit.

Yves Chauvin, i lindur më 1930, është drejtor i nderuar i sektorit të kërkimeve në Institutin francez të naftës. Robert Grubbs, i lindur më 1942, është docent në California Institute of Technology. Richard Schrock jep mësim në Massachusetts Institute of Technology.

* MJEKESI

Shkencëtarët australianë Barry Marshall e Robin Warren u nderuan me çmimin Nobel 2005 në mjekësi për zbulimin e bakterit *Helicobacter pylori* e rolit të tij tek gastriti dhe ulçera peptike. Pas famës pra arrin për ta edhe çmimi prestigjioz.

Helicobacter pylori u zbulua në laboratorët e Perthit ku dy studiuesit punojnë. Marshall për të provuar teorinë e tij se gastriti dhe ulçera kanë origjinë bakteriale në një moment të karrierës gëlltiti një të tillë për të eksperimentuar mbi trupin e tij. Në botën e mjekësisë, që normalisht është shumë e mbyllur, Marshall arriti famë botërore duke i publikuar teoritë e tij në shumë organe të rëndësishme shtypi si *New Yorker*, *Time magazine*, *Reader's Digest*, *The New York Times*, *The Wall Street Journal* e *The Washington Post*. Një ngjarje e rallë për çmimin Nobel pasi zakonisht në fushën e mjekësisë fitojnë ata që janë të panjohur nga masa e gjerë.

Patologët Barry Marshall, 54 vjeç, e J. Robin Warren, 68 vjeç, provuan se inflamacionet e stomakut përfshi edhe ulçerën janë pasojë e një infeksioni të shkaktuar nga *Helicobacter pylori*.

I pari që dyshoi për këtë ishte Warren duke vëzhguar se në gati gjysmën e pacientëve biopsitë tregonin formimin e kolonive bakteriale në pjesën e poshtme të stomakut dhe se shenjat e inflamacionit ishin më të pranishme pikërisht atje ku ndodheshin edhe bakteret.

Duke u nisur nga biopsitë e studiuara nga Warren, Marshall arriti të kultivojë eksperimentalisht bakteret deri sa arriti ti provojë mbi veten e tij efektet e tyre. Dy mjekët arritën kështu të japin demonstrimin përfundimtar që gastriti dhe ulçera shkaktohen nga një infeksion. Ata vëzhguan se edhe pse dhimbjet e ulçerës peptike mund të lehtësohen me anë të ndalimit të acideve gastrike, shumë shpesh simptomat rishfaqeshin sepse ekzistonte inflamacioni kronik i stomakut nga prania e baktereve.

Me eksperimentet e tyre të kryer mbi 100 pacientë, Marshall e Warren së bashku me grupin e bashkëpunëtorëve, treguan se ulçera peptike mund të kurohet vetëm duke zhdukur krejtësisht bakteret e stomakut. Zbulimi i tyre ishte i jashtëzakonshëm sepse qe një revolucion i bindjes se ulçera është një sëmundje kronike: studimet e tyre çuan në shërim mijëra persona me anë të barnave anti-biotike dhe inhibitorëve të aciditetit të stomakut të prodhuar pas këtyre zbulimeve.

* EKONOMI

Çmimi Nobel për ekonominë iu dha izraelianit Robert Aumann e amerikanit Thomas Schelling për kontributin e tyre në shpjegimin e konflikteve ekonomike e sociale në bazë të metodës së teorisë së lojnavë.

Aumann, 75 vjeç, është profesor pranë Centre for Rationality, në Hebrew University në Jeruzalem. Ai ka nënshtetësinë amerikane dhe izraeliane pasi më 1938 së bashku me familjen e tij la Gjermaninë për tu strehuar në Shtetet e Bashkuara. Schelling, 84 vjeç, është profesor i nderuar në Dipartiment of Economics and School Public Policy pranë Universitetit Maryland.

Akademia Mbretërore Suedeze e Shkencave që jep çmimin Nobel në motivacionin e tyre thekson se “të dy ekonomistët kanë kontribuar në shpjegimin e konflikteve ekonomike si luftërat tregëtare e ato të çmimeve dhe sqaruan arsyet se pse disa komunitete arrijnë suksese më të mëdha në shfrytëzimin e burimeve të përbashkëta”. Përpjekjet e përsëritura në simulimet matematikore të të dy ekonomistëve, me metodën e teorisë së lojnavë, sqarojnë shkaqet e qënies së panoramës ekonomike me shumëllojshmëri fenomenesh dhe njësisht, nga korporatat tregëtare tek kriminaliteti i organizuar, nga traktativat mbi pagesat tek tregëtia globale.

* LETERSI

Dramaturgu anglez Harold Pinter merr çmimin Nobel për letërsinë. “Në komeditë e tij” lexohet në motivacionin e Akademisë suedeze “Pinter nxjerr në pah mjerimin që fshihet pas thashethemeve të përditshme e bën rrugën në dhomat më sekrete të shtypjes”.

Djalë i një robaqepësi hebre, Pinter është një nga dramaturgët më të njohur anglezë për veprat *The Birthday Party* e *The Caretaker*. Stilit të tij lakonik, plot me heshtje, i kanë dhënë nofkën “pintoresk”. Këto ditë Pinter mbushi 75 vjeç.

Zgjedhja e dramaturgut anglez habiti pjesën më të madhe të vëzhguesve. Për këtë vit hipoteza të bazuara jepnin si të favorizuar poetin sirian Adonis (Ali Ahmad Said) dhe shkrimtarin turk Orhan Pamuk i cili është nën proces në Turqi me akuzën “për denigrimin e identitetit kombëtar turk” duke përkrahur popullin e masakruar armen. Kandidatë të tjerë ishin amerikanët Joyce Carol Oates e Philip Roth, poeti italian Claudio Magris, poeti suedez Thomas Transtromer, poeti koreanojugor Ko Un, kanadezja Margaret Atwood, çeku Milan Kundera, belgu Hugo Claus dhe indoneziani Ananta Toer.

ISMAIL KADARESE ÇMIMIN NOBEL JA KANE DHENE ME KOHE LEXUESIT NE MBARE BOTEN

nga VASIL QESARI

Eshtë për t'u ardhur tepër keq, është e mjerueshme, cinike, mesquine dhe antikom-bëtare që të fërkosh duart, të shprehësh gëzim dhe keqdashje të papërmbajtur pse shkrimtari ynë i shquar, Ismail Kadare, edhe këtë vit nuk arriti të nderohej me çmimin Nobel. Por, për fat të keq, kjo gjë ndodhi. Ky gëzim i lig, ky pezm, ky helm nuk erdhi nga "zgafellat" e armiqve tanë shekullore, as nga serbët e as nga grekët, të cilët nuk kanë dashur e nuk duan kurrë që emri i Shqipërisë të veçohet, të lartësohet e të nderohet në botë, por nga vetë disa shqiptarë vulgarë, mendjeshkurtër e cinikë, të cilët mbi "bindjet" e tyre të mjera e të përcipta politike, vënë egoizmin, injorancën dhe mjerimin e tyre duke u ngazëllyer thellë për çdo gjë që, pa të drejtë, nuk u jepet shqiptarëve të shquar.

Ky gëzim i tyre bëhet edhe më i helmët dhe i zi, ndërkohë që në botën mbarë po flitet për statusin përfundimtar të Kosovës martire e kur Shqipërisë i kërkohet të përmirësojë sa më shpejt imazhin e saj të keq. Më thoni, a do të kishte ndihmesë më të vyer, më mirënjohëse e të lartë për mbarë kombin tonë, nëse pikërisht tani Ismail Kadareja do t'a kish marrë këtë çmim të lartë? Pa dyshim që po! Por, çmimi në fjalë ju dha dikujt tjetër. Dhe, me sa dëgjojmë e lexojmë, jehona për këtë ishte e vakët, e përciptë, fragmentare e bile edhe e habitshme e, komentet për absurditetin e mënyrës se si jepet ky çmim u bë subjekti i ndërhyrjes së shumë kritikëve, analistëve e intelektualëve të shquar në botë. Është për të ardhur keq pra që, ky çmim i lartë dhe i nderuar, është bërë e po bëhet gjithmonë e më tepër, një instrument i hapur politik, për të ndihmuar realizimin e strategjive të

supershteteve dhe qarqeve të caktuara...

Përvoja e këtyre viteve të fundit, ka provuar se ky çmim i lartë ka dalë jashtë "binarëve" të vlerësimit objektiv e të paanshëm të letërsisë si edhe punës e veprës krijuese të përfaqësuesve të saj me të vërtetë të shquar. Ai është duke luajtur kështu, rolin e një "misionari" për të "qetësuar" zonat e nxehta e problemet e mëdha strategjike e politike në rajone e vende të ndryshme të botës. Bie fjala, në rritjen e sensibilitetit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kinë, ato të lëvizjeve feministe dhe të barazisë gjinore në shoqëritë perendimore, të partizanëve pacifistë e mbështetësve të anti-luftës në Irak, ndërgjegjësimit të popujve që janë përfshirë nga integralizmi fanatik musliman etj.

Por, ndërkohë, për mendimin, tim një gjë është tepër e qartë! Ismail Kadare, shkrimtari ynë i madh e krenaria jonë kombëtare në fushën e letërsisë botërore, e ka fituar *de juro* me kohë çmimin Nobel. Atë, atij ja kanë dhënë prej vitesh lexuesit e tij anë e mbanë globit e, krahas tyre edhe mjaft organizma e institucione të tjera të rëndësishme kulturore ndërkombëtare. Për fatin e mirë të shqiptarëve të vërtetë si edhe të mbarë atyre lexuesve në të gjithë kontinentet që lexojnë dhe adhurojnë veprën e tij të shquar (e cila përmbledh stolitë më të bukura të shpirtit dhe historisë së kombit tonë), Ismail Kadare tashmë e ka ndërtuar, siç shprehet edhe ai vetë "shtëpinë e tij" botërore të letërsisë dhe nderime të tilla siç çmimi Nobel, një ditë do t'i jepen me nderet që i takojnë. E ajo do të jetë një ditë e gëzueshme për të gjithë ne...

KLASIFIKIMI I STUDIUESVE SIPAS TREGUESIT “H”

nga NIKO QAFOKU

Shkrimi i mëposhtëm i Philip Ball është botuar në një nga numrat e fundit të revistës *Nature*, në rubrikën “Të reja”. Më poshtë do të gjeni përshtatjen në shqip të disa pjesëve të këtij shkrimi.

Mesazhi kryesor i shkrimit është që sasia e artikujve të botuar në revista shkencore nuk është treguesi i vetëm i cilësisë së punës shkencore të kryer nga një shkencëtar/studiuës. Një tregues që bazohet jo vetëm në numrin e përgjithshëm të artikujve të botuar por edhe në numrin e citimeve që ka marrë çdo artikull, mund të pasqyrojë më saktë cilësinë e punës shkencore të një shkencëtari.

Pasi lexon këtë artikull mund ti bëni vehtes pyetjen: Cili është treguesi im “h” dhe çfarë duhet të bëj që ta kem atë edhe më të lartë? Alb-Shkenca mund t’ju ndihmojë me përgjigjet...

Procedurat e zgjedhjes së anëtarëve të institucioneve honorifike akademike janë shpesh jo transparente dhe në dukje, subjektive. Por Jorge Hirsch, fizikan në University of California, San Diego, ndoshta ka gjetur një metodë që vlerëson dhe mat në mënyrë transparente nivelin e kërkimit shkencor të një studiuesi shkencor. Dhe kjo është metoda e treguesit “h”. Ky tregues llogaritet duke u bazuar jo vetëm në numrin e përgjithshëm të publikimeve të një shkencëtari, por edhe në faktin se sa ka ndikuar puna e tij në veprimtarinë e kolegëve të së njejtës disiplinë shkencore. Pa dyshim kjo, një metodë që do të bënte renditjen sa më objektive të shkencëtarëve, pra që do të evitonte subjektivizmin në zgjedhjen e kandidatëve për pozicione të tilla si anëtarë të US National Academy of Sciences (NAS) apo Britain’s Royal Society, do të kishte vlera të veçanta.

Sidney Redner i Boston University merret me përzgjedhjen e kandidatëve të American Physical Society (APS) për t’i propozuar ata për tu bërë anëtarë nderi (fellow) të kësaj shoqate. Ai thotë që përveç cilësisë së kërkimit të kandidatit, janë shpesh faktorë të tjerë vendimtarë për një përzgjedhje të tillë. Ai shpreh: “Në qoftë se nuk je njeri politik, është vështirë të propozohesh/emërohesh për tu bërë anëtar nderi i APS-së”. Redner gjithashtu mendon se metoda

e Jorge Hirsch-it e treguesit “h” mund të luajë një rol pozitiv në këtë drejtim.

Por çfarë përfaqëson treguesi “h” dhe si llogaritet ai?

Treguesi “h” përfaqëson numrin më të madh të artikujve shkencorë të botuar nga një shkencëtar, të cituar të paktën “h” herë secili. Pra, një studiues që ka këtë tregues 50, ai ka botuar 50 artikuj dhe secili prej tyre është cituar të paktën 50 herë.

Pretendohet që kjo metodë të jetë më e drejtë në krahasim me atë që mbështetet vetëm në numrin e përgjithshëm të artikujve të botuar. Në qoftë se do të mbështeteshim vetëm në këtë numër atëhere do të rrezikonim të lavdëronim ose të shpërblenim autorët me shumë artikuj që në fakt mund të jenë edhe mediokër. Nga ana tjetër, në qoftë se do të mbështeteshim vetëm në disa artikuj që mund të jenë cituar shumë herë, kjo ndoshta nuk do të ishte treguesi i një vëllimi të madh dhe i një vazhdueshmërie në punë.

Për më tepër, duke përdorur treguesin “h” ulet mundësia e manipulimit nëpërmjet vetë-citimit. “Kjo metodë nuk mund të manipulohet, thotë Hirsch, sepse mbështetet në atë se si vlerësohet e gjithë puna shkencore e një studiuesi në një periudhë relativisht të gjatë kohë”. “Të manipulosh të gjithë karrierën është tepër e vështirë”, thotë edhe Redner.

Metoda e treguesit “h” u zbatua fillimisht për të klasifikuar fizikanët më të mirë në botë. I pari në këtë listë është Ed Witten i Princeton University. Ai ka një tregues “h” të barabartë me 110. Witten i teorisë-M, vlerësohet nga kolegët e tij si fizikani më brilant në botë (shih intervistën e zgjeruar në numrin e kaluar të Buletinit).

Lista e fizikanëve të tjerë të renditur sipas treguesit “h” vazhdon në fund të këtij shkrimi.

Hirsch mendon se në qoftë se një shkencëtar ka një tregues “h” të barabartë me 20 pas rreth 20 vjetëve punë shkencore, kjo gjë tregon që ai ka qenë i suksesshëm. Një tregues “h” i barabartë me 40 ndoshta është karakteristikë për një shkencëtar shumë të mirë (*outstanding*) që punon në një laborator të famshëm.

Hirsch gjithashtu mendon që *tenure* i profesorëve të universitetit duhet tu jepet atyre që kanë një tregues “h” të barabartë ose mbi 12. Për tu bërë *fellow* i një shoqate shkencore

duhet të kesh një tregues “h” 15-20 dhe për tu bërë anëtar i National Academy of Sciences do të mjaftonte një tregues “h” i barabartë me 40. Anëtarët e rinj të pranuar vitin e kaluar në National Academy of Science në Amerikë në fushën e fizikës dhe astronomisë e kishin treguesin “h” të barabartë me 44.

Megjithëse Hirsch është i mendimit që rezultatet e kësaj metode mund të shërbejnë edhe për të krahasuar punën e shkencëtarëve të disiplinave të ndryshme, ai mendon gjithashtu që do të ketë disa probleme në zbatimin e këtij sistemi. Për shembull, biologët mund të arrijnë të kenë një tregues “h” të barabartë me 190. Kjo ndodh sepse disiplina të ndryshme shkencore kanë trende të ndryshme të citimit të artikujve.

Ja edhe lista e fizikanëve më të mirë në botë të

renditur sipas treguesit “h”:

110. Ed Witten, Princeton Institute for Advanced Study

94. Marvin Cohen, University of California, Berkeley

91. Philip Anderson, Princeton University (Çmim Nobel më 1977)

86. Manuel Cardona, Max Planck Institute for Solid State Research

79. Pierre-Gilles de Gennes, ESPCI, Paris (Çmim Nobel më 1991)

68. Frank Wilczek, Massachusetts Institute of Technology (Çmim Nobel më 2004)

66. David Gross, Kavli Institute for Theoretical Physics, Santa Barbara (Çmim Nobel më 2004).

Tridhjetë centralet më ndotës në Europë

WWF publikoi këto ditë klasifikimin e 30 centraleve elektrike më ndotës në Europë. Përgjegjësit kryesorë për këtë ndotje janë Greqia, Gjermania e Spanja.

Pas një vere me përmbajtje, thatësi e valë të nxehti të jashtëzakonshme gishti akuzues i fenomenit të ndryshimit klimatik është drejtuar edhe ndaj “Dirty Thirty”, 30 centralet përgjegjës për sasinë më të madhe të anhidridit karbonik (CO₂) të çliruar në atmosferë ku 27 nga këta ushqehen me qymyr. Agios Dimitros në Greqi, Frimmersdorf në Gjermani e Abono në Spanjë ndodhen në krye të klasifikimit.

WWF mori në konsideratë çlirimet e përgjithshme të CO₂ (milionat tonelata në vit) të centraleve që ndodhen në 25 vendet e Komunitetit Europian dhe i klasifikoi përgjegjësit kryesorë sipas shkallës së tyre të efikasitetit (gr CO₂ të çliruar për 1 Kwh). Pjesa më e madhe e centraleve ndotës ndodhen në Gjermani (9), Poloni (5), Italia, Spanjë e Britani e Madhe (3). Në Greqi ndodhen dy centralet e ushqyer me linjit që janë klasifikuar i pari dhe i katërti.

Sipas ekspertëve, çlirimi i CO₂ është shkaku kryesor i ngrohjes globale dhe i impaktit shkatërrues të ndryshimeve klimatike mbi natyrën dhe njeriun. “Sektori energjetik është përgjegjës për 37% të çlirimit të CO₂ me origjinë antropike” thotë Mariagrazia Midulla, përgjegjëse e fushatave ndërkombëtare WWF. “Centralet me qymyr janë ato më ndotëse sepse përdorin materialin

me sasi më të lartë CO₂. Për të ndalur ngrohjen globale duhet të zëvendësojmë qymyrin e naftën me alternativa më të pastra, duke përdorur gazin si burim tranzicioni e duke këmbëngulur më shumë tek burimet e rinovueshme të energjisë. Rëndësi të madhe ka edhe efikasiteti energjetik i cili tashmë shihet në nivelin ndërkombëtar si një burim më vete energjie”.

Klasifikimi tregon qartë se janë gjashtë shoqëri të vetme pronare të centraleve më ndotës. Ndër to gjejmë RWE (Gjermani), Vattenfall (Zvicër), Enel (Itali), Endesa (Spanjë), E.ON (Gjermani) e grupi francez EDF.

Gjatë njëzet vjetëve të ardhshëm shumë prej centraleve të mësipërme do jenë në fund të ciklit të tyre, një rast historik ky për zëvendësimin e tyre me ata me gaz duke çuar brenda vitit 2030 në një ulje prej 47.8% të çlirimit të CO₂ në atmosferë. Kalimi në teknologji të reja por që përdorin përsëri qymyrin do të çonte vetëm në një ulje modeste të ndotjes prej 13.5% e pakrahasueshme me 73.4% pakësim nëse do të kemi kalimin në centrale që përdorin burime energjie të ripërtëritshme e të pastra.

Një pjesë e rëndësishme e zgjidhjes së problemit të çlirimit të CO₂ nga sektori energjetik është edhe tregu i kuotave të çlirimit, ETS (Emission Trading System).

World Wildlife Found

1 tetor 1842 – Riprodhimi i tingujve Beatles, Rolling Stones e Madonna ia detyrojnë pjesë të suksesit të tyre poetit dhe aktorit të ri francez Charles Cros i lindur këtë ditë në Frabezan. Ai më 1877 u paraqiti në Akademinë franceze me projektin për realizimin e një sistemi incizimi të tingujve mbi një disk metalik (projekt që nuk u realizua kurrë). Pak muaj më vonë, Thomas Edison në laboratorin e tij do të ndërtojë fonografin e parë. Por Edisoni kish në mendje një sistem për regjistrimin e mesazheve kryesisht në zyra e jo për riprodhimin e muzikës.

4 tetor 1957 – Pushtimi i hapësirës Sfida filloi: hapësira nuk ka më kufij. Bashkimi Sovjetik dërgon në orbitë satelitin e parë artificial, Sputnik 1, një sferë metalike me diametër 58 cm e rreth 80 kg. Ai u soll rreth Tokës në një lartësi 227-941 km deri ditët e para të vitit 1958, kur ra duke u shkatërruar në atmosferë. Rusët fituan në kohë ndaj amerikanëve që prej kohësh po përgatishnin projektin Vanguard, i cili më pas dështoi plotësisht. Përgjigja e ShBA-së arriti vetëm në janar 1958 kur u lëshua Explorer 1, një satelit i projektuar nga Wernher von Braun.

6 tetor 1846 – Freno shpejt Në vitet '800 trenat nuk ishin ata që janë sot përfshi këtu edhe mjetet e sigurisë. Mjafton të flasim për sistemin primitiv të frenimit: një person në çdo dy vagona përdorte një fren dore. I riu 23 vjeçar George Westinghouse, i lindur këtë ditë në New York, shpiku sistemin e parë të frenimit të trenave me ajër të ngjeshur. Ende sot freni i shpikur nga Westinghouse më 1869 është më i përdoruri në hekurudhat e mbarë botës.

9 tetor 1676 – Homunkuli e spermatozoi Duke vëzhguar në mikroskop lëngun e tij seminal, një tregëtar holandez zbuloi spermatozootë. Duke dërguar lajmin në Royal Society, ai i quan ata "homunkuli" duke i konsideruar ata si persona mikroskopikë. Për shumë kohë u besua se "homunkujt" depozitoheshin e rriteshin në uterusin e gruas pa asnjë ndikim nga ana e saj. Vetëm më 1875 një mjek gjerman dalloi parimin e fekondimit. Gjendej rastësisht duke vëzhguar çiftëzimin e dy iriqëve të detit dhe pa hapur spermatozoonin të hyjë në ovulë.

11 tetor 1705 – Temperatura Të shumtë kanë qenë shkencëtarët që punuan për realizimin e një termometri gjithnjë e më të perfeksionuar. Neri prej tyre, fizikani francez Guillaume Amontons që vdiq këtë ditë. Më 1699 përdori termometrin e tij për të provuar nëse uji vlonte gjithmonë në të njejtën temperaturë. Megjithë përpjekjet e shumta, për një termometër të saktë mund të flitet vetëm në vitet '800 me Gabriel Daniel Fahrenheit. Ky tregëtar gjerman përdori mërkurin në vend të alkolit dhe vendosi një shkallë termometrike universale që përdoret edhe sot.

12 tetor 1965 – Njeriu i DDT-së Një kërkues zvicerian Paul Müller më 1939 zbuloi se diklorodifeniltrikloroetani është një insekticid shumë i fuqishëm. I quajtur DDT, u përdor për herë të parë në Napoli më 1944 kundër epidemisë së tifos shkakuar nga morrat. Ky produkt u quajtur mrekullues e për zbulimin e tij Müller mori çmimin Nobel më 1948. I përdorur për rreth njëzet vjet në problemet shtëpijake dhe bujqësore suksesi i DDT-së u mbyll në vitet Shtatëdhjetë kur u zbulua se ky produkt ishte shkatërrues për të gjithë zinxhirin ushqimor, bimor e shtazor.

13 tetor 1914 – Kapuçi i gazit Garret Morgan patenton kundragazin. Ai përbëhet nga një kapuç stufe i cili lidhet me dy tuba që më pas bashkohen në një tub të vetëm mbrapa kurrizit. Në fund ndodhej një sfungjer i lagësht për të filtruar tymin. Ky zbulim i Morganit arriti suksesin e tij më 1916 kur pas një eksplozioni në një galeri midis ShBA-së dhe Kanadasë, 32 persona u shpëtuan falë maskave kundragaz. Ishte personalisht Morgani që hyri në galeri me "kapuçin e tij të sigurisë" dhe shpëtoi burrat e bllokuar nën tokë.

15 tetor 1878 – Liambushka Ishte viti 1878 kur Thomas Edison dëgjon se në botë po bëheshin përpjekje për të ndërtuar një llampë elektrike. Kështu më 15 tetor ai themelon Edison Electric Light Company e nis eksperimentimet. Problemi kryesor ishte ai i gjetjes së një filamenti që të bëhej inkandeshent me kalimin e rrymës elektrike pa u djegur. I mbyllur në laborator ai provoi mijëra materiale nga fijet e kartonit tek qimet njerëzore, fije bimorë ekzotike etj. Më në fund u pa se fija e zakonshme prej pambuku e përdorur për qepje kur karbonizohej e kalonte provën e Edisonit.

17 tetor 1888 – Eksplorimi Me një kopertinë me një bord të verdhë dhe disa shërbime fotografike bardh e zi doli në Washington numri i parë i revistës "National Geographic", organ zyrtar i National Geographic Society. E lindur në epokën kur nuk njiheshin turizmi i masës dhe udhëtimet interkontinentale, revista u ofrua ti njihje lexuesit me vende e rajone të botës që nuk do të kishin kurrë mundësi të vizitonin. "National Geographic" u bë për një kohë të shkurtër një nga të përmuajshmet më të shitura në botë: sot arrin një tirazh prej 10 milionë kopjesh.

19 tetor 1909 – Sëmundja kriminale Shkencëtari themelues i antropologjisë kriminale Cesare Lombroso vdes në Torino. Ai u bë i famshëm për teorinë e tij të diskutueshme mbi kriminalitetin si sëmundje. Duke analizuar qindra kafka, Lombroso arriti të përcaktonte shenja fiziologjike precize për të dalluar një kriminel qysh nga lindja. Një nga këto shenja është e futura oksipitale (zona e pasme e kokës) që haset vetëm tek kafshët e ulëta. Sipas Lombrosos për "kriminelët e lindur" nuk ka as kurë as edukim por vetëm dënim në "çmendinën kriminale" e në rastet më të rënda dënimi me vdekje.

23 tetor 1921 – Pedalimi Më 1888 veterinerit skocez John Boyd Dunlop duke parë triciklin e djalit i erdhi në mendje që të përdorë në vend të gomave të forta të përdorte një "dhomë ajri" për ti lehtësuar. I frymëzuar nga topi i futbollit ai futi në të dy gomat nga një tub me ajër. Djali pedaloi për një orë dhe kur u kthye i lumtur tha "mu duk sikur po ecja mbi re". Vitin që vijoi një skuadër çiklizmi përdori gomat me ajër të Dunlopit duke arritur një fitore të paharruar.

25 tetor 1960 – Matja e kohës Ora e parë e xhepit u shpik nga një fabrikant gjerman çelësash në shek. XVI dhe kish vetëm akrepin e orëve. Pas vitit 1960 filluan të tregëtohen në masë orët e dorës me saktësi të madhe. Eshtë rasti i Bulovës që më 25 tetor 1960 nxori në treg orën e parë elektronike. E vetëm nëntë vjet më vonë doli ora e parë me kuarz. Çmimi i saj ishte tepër i lartë: 1250 dollari. Por ora më e kushtueshme në botë mbetet "Supercomplication" i shitur në ankand për shifrën rekord 11 milionë dollarë.

26 tetor 1984 – Derrat transgjenikë Për herë të parë në botë një kirurg trapianton zemrën e një babuini tek një vajzë 12 ditëshe që kish hipoplazi kardiale (zemër tepër të vogël). Foshnja mbijetoi vetëm 20 ditë por u hap rruga e eksperimentimit të trapianteve të organeve të kafshëve tek njeriu (ksenotrapiantet). Më 1992 lindi Astrid dosa e parë me organe të "humanizuar" për trapiante: në trashëgiminë gjenetike të derrit u fut një gjen që çbllokonte mospërputhshmërinë me organet njerëzore. Qysh atëherë u vazhdua eksperimentimi i "fabrikimit" të derrave transgjenikë.

29 tetor 1969 – Fillimet e internetit Professor Kleinrock në Los Angeles (UCLA) me një grup të vogël studentësh tenton të kryejë një log-in tek një kompjuter i universitetit të Stanfordit, San Francisco. Arrin të transmetojë deri tek gërma "g" e fjalës "log-in" ("kërkesë për lidhje"), para se ndërlihdja të shkëputet. Janë gërmat e para të transmetuara në rrjetin Arpanet e provojnë se është e mundur që dy kompjuter në distancë mund të komunikojnë. Eshtë hapi i parë i lindjes së Internetit. Arpanet ishte një projekt i ministrisë amerikane të mbrojtjes.

30 tetor 1937 – I vëzhguari special Një asteroid me diametër një kilometër për një qime nuk godet Tokën: kalon vetëm 800.000 kilometra larg saj. Aktualisht disa studiues po vëzhgojnë orbitën e "2002 CU11", një asteroid me diametër 700 metra që, sipas disa përlogaritjeve, ka një mundësi ndër 9300 të përplaslet me Tokën më 2049, me pasoja shkatërruese. Në verën e vitit 2002, shumë organe shtypi dhanë alarmin për një asteroid tjetër, 2002 NT7, që mund të arrijë më 2019.